



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:073816

Datë: 23.07.2019

Numri i dokumentit: 00421740

P.nr.98/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL Sipas gjyqtarit Refki Piraj, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit Halime Nixha në lëndën penale kundër të pandehurit S.M nga ..., me numër personal ..., për shkak të veprës penale Lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore Prizren - Departamenti i përgjithshëm nr. PP/II.nr.3179-11/18 , të datës 21.01.2019 në praninë e Prokurorit të Shtetit Naim Gashi të pandehurit S.M, me datë 23.07.2019 mori i, këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri S.M i lindur më ..., me numër ..., i biri i G. M dhe nënës H. M, e gjinisë , me vendbanim në , ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar babe i ...femive, i pa pune i gjendjes së dobët ekonomike turk shtetas i R. të Kosove.

ËSHTË FAJTOR

Se me dt. 17.10.2018 në shtëpinë e tij e cila gjendet në ... gjatë një kontrolli të bere nga ana e kompanisë ..., rezultoi se i pandehuri me qëllim që të perfitojë në mënyrë të kundërligjshme nga shërbimi komunal, shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë direkte pasi që i njëjti paraprakisht ishte shkyqur nga rrjeti i energjisë elektrike nga distanca për shkak të borxhit, ashtu që i pandehuri rikyqet në përqendrim elektrik duke krijuar një lidhje të re direkte jashtë njehsorit duke i shkaktuar dem material të dëmtoarës ...

-këso dore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 të KP-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 3, 38, 46, 48, 69 të KP t e akuzuarit i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i pandehuri nuk kryen vepër të re penale.

E dëmtuara ... për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet I pandehuri që ti paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato bëhen në bazë të llogarisë së gjykatës, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Në zbatim të ligjit mbi mbrojtjen e viktimave të krimit të akuzuarit i caktohet taksa në lartësi prej 30 euro të cilën është i obliguar ta paguaj në xhironlogarinë e kësaj gjykate në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë.

A r s y e t i m

Prokuroria themelore në Prizren ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr. 3179-11/18 , të datës 21.01.2019 ndaj të akuzuarit S.M nga ... për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 321 të KP.

Prokurori i shtetit në fillim të shqyrtimit fillestar në zbatim të nenit 3 të KP-së përkitazi me zbatimin e ligjit me të favorshëm kërkon nga gjyqtari gjykues që të zbatohet neni 314 i KP në fuqi krahasuar me nenin 321e KP i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

I pandehuri S.M në shqyrtimin fillestar , në tërësi ka pranuar veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës , e po ashtu ka pranuar edhe fajësinë .

Gjyqtari gjykues përcaktoi se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, dhe mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike dhe pas marrjes së mendimit nga ana e prokurorit të shtetit ka pranuar pranimin e fajësisë.

Kjo gjykatë gjeti se në veprimet e të akuzuarit , plotësohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga Neni 314 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (KPRK), prandaj dhe ia shqiptoi dënimin e kushtëzuar me burg në kohëzgjatje prej 4 muaj cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i pandehuri nuk kryen vepër të re penale, duke qenë i bindur se me këtë lloj dënimi do të arrihet qëllimi i të njëjtit.

Me rastin e shqiptimit të dënimit kjo gjykate pati parasysh si rrethana lehtësuese, pranimin e fajit, shprehjen e pendimit , premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej me vepra penale, sjelljen korrekte para gjykatës, është familjar , e gjendjes së dobët ekonomike, dhe se për herë të parë ka ra ndesh me ligjin. Me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobe gjykata pati për bazë gjendjen e dobët ekonomike të të akuzuarit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në kuptim të nenit 450 dhe 452 të KPPK-se.

Vendimi mbi udhëzimin në kontest civil u mur në kuptim të nenit 463 par.2 të KPPK.

Më sa u tha më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2019:073816, 23.07.2019

G j y q t a r i

Refki Piraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.